



**Si të regjistrojme kërkesën ndaj Ndërmarrjes në Pronësi Shoqërore në Riorganizim
Pyetjet e parashtruara shpesh**

Kërkesat kundër Ndërmarrjes në Pronësi Shoqërore (NSH) në riorganizim nën administrim të AKP-së në përputhje me nenin 7.5.3 të ligjit Nr. 04/L-035 mbi Riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre

Pretenduesit potencial duhet të sigurojnë se i kanë marr parasysh të gjitha ligjet dhe rregulloret relevante me kujdes dhe se kanë marr parasysh pranimin e këshillave nga ekspertet ligjor në lidhje me çfarëdo kërkesë që mund të kenë ata ndaj NSH-ve të caktuara ose asetet e tyre në riorganizim

Ky dokument nuk ka fuqi të ligjit dhe nuk është asgjë më tepër sesa një përmbledhje e çështjeve specifike që duhet të merren parasysh nga ndonjë pretendues potencial. Ky dokument-përmbledhje, për nga definicioni, nuk është gjithëpërfshirës dhe nuk i mbulon të gjitha fushat e ligjit dhe procedurat. Nuk është zëvendësim për rishqyrtim të ligjeve dhe rregulloreve, sidomos ato që janë te cekura në paragrafin 2 më poshtë. Pretenduesit potencial duhet të kenë konsideratë ndaj faktit se ky dokument nuk është juridikisht i detyrueshëm dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillë juridike bazë.

1. Çka është riorganizimi?

Riorganizimi është ristrukturim profesional i borxheve dhe/ose operimeve të biznesit të Ndërmarrjes në një mënyrë që arsyeshëm mund të pritët të kthej shanset për sukses të Ndërmarrjes si të qëndrueshëm në të ardhmen dhe që ofron për shqyrtimin përfundimtar të të gjitha kërkesave dhe interesave në përputhje me Ligjin mbi Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Asetet e tyre.

Gjatë procesit të riorganizimit secili që ka një kërkesë ndaj NSH-së duhet të ketë mundësinë të parashtrorë kërkesën që do të shqyrtohet nga AKP-ja i cili do të veproj si Administrator i Ndërmarrjes në riorganizim. Administratori duhet të vlerësoj të gjitha kërkesat dhe të njoftoj kreditorët individual nëse kërkesa e tyre është pranuar. Nëse kërkesa e kreditorit është shqyrtuar dhe pranuar kreditori ka të drejtë të votoj për planin për riorganizim të propozuar nga Administratori ose nën rrethana të caktuara nëse kualifikohet të propozoj planin alternativ për riorganizim.

2. Ku mund të gjejë ligjin përkatës lidhur me të drejtat e AKP-së dhe procedurën e riorganizimit?

Rregulloret kryesore në vijim mund të gjenden në ueb faqen e AKP-së www.pak-ks.org nën "Ligjet dhe Rregulloret", nën sektori "Trepça". Kjo nuk është listë e plotë e legjislacionit të zbatueshëm dhe ankuesit këshillohen të konsultojnë juristët profesional. Ligji në fuqi do të varet në datat dhe natyrën e çështjes me të cilën ka të bëjë kërkesa. Për shembull, disa rregullore të UNMIK-ut qeverisin kontratat dhe obligimet e NSH-ve si në vijim:

- a) Ligji Nr. 04/L-035 mbi Riorganizim e ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre
- b) Rregullorja e UNMIK-ut Nr 2003/13 mbi transformimin e të drejtës për përdorimin e pronës së patundshme, e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2004/45 ("Rregullorja për shfrytëzimin e tokës").
- c) Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (dhe ndryshimet)
- d) Ligji Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për Dhomën e Posaçme).

Ju lutem vëreni që lista e mësipërme është **vetëm treguese** dhe nuk ka për qëllim të jetë listë gjithëpërfshirëse e ligjeve dhe rregulloreve relevante.

3. Çka është Kërkesa e Kreditorëve?

Kërkesa e Kreditorëve është Kërkesë e bërë nga personi fizik dhe juridik që pretendon të drejtat e pretenduara për pagesë nga ose performansa e Ndërmarrjes.

4. Si të regjistroj kërkesë të kreditorit ndaj Ndërmarrjes në Riorganizim?

Nëse keni një kërkesë që ka të bëjë me NSH-në në riorganizim për të cilën pas Moratoriumit është publikuar njoftimi “Njoftimi për Afatin e Kërkesës” ju duhet të regjistroni kërkesën tuaj në AKP duke kompletuar dhe dorëzuar me **Formularin e Dëshmisë së Kërkesës**.

5. Si të regjistroj kërkesën për Pronësi?

Në rast se keni kërkesë për pronësi ndaj asetit specifik të poseduar ose kontrolluar nga NSH-ja ose interesi në pronësi në kapital të NSH-së si partner, themelues, pjesëmarrës, pronar, aksionar ose ortak, atëherë duhet të plotësoni **Formularin për Dëshmi të Interesit**.

6. Si do të di që Njoftimi për Riorganizim është publikuar?

AKP-ja si Administrator për Ndërmarrjen duhet të publikoj Njoftimin për Afatin e Kërkesës brenda 360 ditëve pas publikimit të Vendimit për Moratorium. Njoftimi për Afatin e Kërkesës duhet të publikohet herën e dytë brenda 30 deri 40 ditë pas publikimit fillestar të Njoftimit për Afatin e Kërkesës si kujtues për të gjithë kreditorët pretendues dhe bartësit e interesuar të parashtrajnë kërkesën e tyre. Kopja e këtyre 2 publikimeve gjithashtu duhet të publikohet në ueb faqen e AKP-së: www.pak-ks.org.

7. Ku mund të marrë Dëshminë e Kërkesës ose Dëshminë e Interesit?

Formularët për Kreditor dhe Interesit për Pronësi të AKP-së mund të merret në receptionin e ZQ të AKP-së (Prishtinë) ose në Zyret Rajonale të AKP-së në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan. Formularët gjithashtu mund të mund të shkarkohen nga ueb faqja e AKP-së www.pak-ks.org në sektorin “*Formularët e Kërkesës për Riorganizim*”

8. Pse duhet të parashtraj Formularin e Kërkesës për Riorganizim?

Nëse keni kërkesë ndaj NSH-së, ju keni të drejtë të parashtroni Dëshminë e Kërkesës ose Dëshminë e Interesit dhe të mbronni të drejtat tuaja. Administratori (AKP) i NSH-së në riorganizim mund të pranoj në tërësi ose pjesërisht dëshminë e kërkesës ose dëshminë e interesit të dorëzuar dhe ju do të bëheni “Kreditor i Regjistruar” ose “Bartës i Regjistruar i Interesit” varësisht në natyrën e kërkesës suaj, nëse ajo është e bazuar në detyrimet e NSH-së ndaj jush ose ju kërkoni interes në pronësi për asetet specifike ose për kapitalin e NSH-së. Ky status mund të ndryshoj nëse Gjykata më pas urdhëron që Dëshmia e tillë e Kërkesës ose Dëshmia e Interesit të anulohet tërësisht.

Kreditori i Regjistruar ose Bartësi i Regjistruar i Interesit ka të drejtë të merr pjesë në procedurat e riorganizimit të NSH-së duke votuar për ose kundër planit për riorganizim propozuar nga AKP-ja. Në rast se Kreditori i Regjistruar ose Bartësi i regjistruar i interesit individualisht ose kolektivisht përfaqëson një shumë, të llogaritur në Euro, e barabartë me (5%) ata bëhen Kreditor të Kualifikuar ose Grup i Kualifikuar i Kreditorëve, të cilët kanë të drejtën të propozojnë planin e riorganizimit.

9. A ka afat për regjistrimin e Formularit të Kërkesës për Riorganizim?

Po. Ju duhet të parashtroni Dëshminë e Kërkesës ose Dëshminë e Interesit përmes formularëve përkatës së bashku me të gjithë dokumentacionin brenda afatit të paraparë në Njoftimin për Afatin e Kërkesës publikuar në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe në gazetë me tirazh të gjerë në Kosovë; në gazetën në gjuhën serbe që ka tirazh të madh në Serbi dhe Mal të Zi; dhe në gjuhën angleze që ka tirazh të madh në Evropë. Kopjen e Njoftimit për afatin e kërkesës mund të gjeni në ueb faqen e AKP-së www.pak-ks.org në sektorin “Trepça”

10. Ku duhet të parashtrorj të plotësuar Formularin e Kërkesës për Riorganizim?

Formularin e Kërkesës për Riorganizim duhet të parashtroni me të gjitha dokumentet mbështetëse sipas udhëzimeve të ofruara në Njoftimin për Afatin e Kërkesës.

11. Si duhet të parashtrorj Formularin e Kërkesës për Riorganizim?

Formularin për Dëshmi të Kërkesës ose Formularin për Dëshmi të Interesit mund të parashtroni përmes postës së regjistruar, korrierit ose personalisht. Këshilloheni të merrni konfirmimin e dëftesës. Kërkesat që janë parashtruar nga posta e regjistruar ose korrieri duhet të parashtrohen në afatin e paraparë në Njoftimin për Afatin e Kërkesës.

12. A duhet të paguaj ndonjë tarifë për dorëzimin e Formularit të Kërkesës për Riorganizim?

Nuk ka nevojë të paguhet asnjë tarifë për dorëzim të formularëve.

13. Në cilën gjuhë duhet të parashtrorj Formularin e Kërkesës për Riorganizim?

Kërkesën tuaj mund të parashtroni në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës (në gjuhën shqipe ose gjuhën serbe). Nuk keni nevojë të parashtroni në të dy gjuhët. Çfarëdo dokumenti mbështetës duhet të dorëzohet në gjuhën origjinale (e cila mund të jetë tjetër gjuhë përveç gjuhës shqip dhe serbe). Në rast se e keni përkthimin ju lutem e bashkëngjiteni dhe tregoni që janë përkthime.

14. A duhet të përdori Formularin e Kërkesës për Riorganizim?

Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe asetet e tyre kërkon që ankuesit të parashtrorj në dëshminë e kërkesës ose dëshminë e interesit në formularin e përshkruar nga Gjykata dhe përcaktimin e informatave dhe detajeve të përcaktuara në nenin 17 të ligjit. Në rast të dështimit të dorëzimit siç duhet formularin e dëshmisë brenda afatit kohor, kërkesa e juaj do të konsiderohet e joligjore.

15. Cila është data që Formulari i Kërkesës për Riorganizim konsiderohet si i dorëzuar?

Formulari i Kërkesës për Riorganizim duhet të konsiderohet si i dorëzuar në datën kur është pranuar nga AKP-ja dhe për të cilën AKP-ja do të lëshoj një dëftesë konfirmimi.

16. Si mund të di nëse Formulari i Kërkesës për Riorganizim është pranuar nga AKP-ja?

Nëse keni dorëzuar kërkesën tuaj në AKP, ju do të pranoni një dëftesë konfirmuese. AKP-ja do të informoj nëse kërkesa e juaj është pranuar në tërësi ose pjesërisht, dhe nëse kërkohet dëshmia shtesë për të mbështetur kërkesën tuaj. Dëftesën konfirmuese e përdorni si referencë për korrespondencën tuaj me AKP-në.

17. A duhet të dorëzoj kërkesën e kreditorit prapë nëse kam dorëzuar më parë kërkesën kundër Ndërmarrjes në të kaluarën pranë Gjykatës, AKP-së ose paraardhësi i saj?

Po, ju duhet të dorëzoni sërish kërkesën tuaj me informatat e deritanishme për shkak të ndryshimeve në legjislacion gjë që e kërkon atë. AKP-ja gjithashtu duhet që brenda dhjetë (10) ditëve pas datës së Njoftimit për Afatin e Kërkesës së pari është publikuar, dërgo një kopje të njoftimit të tillë për secilin person i cili më parë dhe

me shkrim ka informuar Agjencinë ose Gjykatën për kërkesën, ose interesin e pretenduar për Ndërmarrje ose Ndonjë Aset të Ndërmarrjes.

18. Si të veproj me dokumentet mbështetëse? A duhet të dërgoj origjinalët apo vetëm kopjet e dokumenteve mbështetëse p.sh. dokumentet kadastrale, kontrata etj? Në rast se e dërgoj origjinalët a do të më kthehen të njëjtat?

Duhet të dorëzoni të gjitha dokumentet përkatëse për të ndihmuar Administratorin (AKP-në) në vlerësimin e kërkesës suaj kreditore. Ju lutem ofroni sa më shumë detaje që është e mundur dhe nëse kërkohet ofro kopjet e kontratave, faturave, shkresat kujtuese, dëshmi të gjykimeve, detaje të normave të interesit, të dhënave kadastrale, lejet e ndërtimit etj.

Duhet të ofroni listën e të gjitha dokumenteve që i parashtroni dhe bashkëngjiteni me dokumentet e Formularit të Kërkesës për Riorganizim. Nëse besoni që kjo do të ndihmoj Administratorit në bërjen e vlerësimit të kërkesës suaj të kreditorit, gjithashtu duhet të bashkëngjiti një histori të shkurtër që sqaron se si kërkesa e juaj është parashtruar.

Sidoqoftë, ju lutem **mos dërgoni** dokumentet origjinale në këtë fazë. Megjithatë, AKP-ja mund të kërkoj dokumentet origjinale në faza të mëvonshme.

19. A duhet të dorëzohet sërish ndonjë dokument mbështetës që është dorëzuar para Njoftimit për Afatin e Kërkesës kur të dorëzohet kërkesën e kreditorit?

Po. Kjo është kërkesë ligjore.

20. A mund të parashtrohet kërkesë për interes?

Po, mund të parashtrohet kërkesë për interes dhe nëse parashtrohet kërkesa, kjo duhet të bëhet ndaras në mënyrë që të jetë e qartë se sa ka borxh të përgjithshëm dhe përkatësisht borxhi kryesor dhe interesi i akumuluar. Gjithashtu duhet të ofroni bazë ligjore për të cilën interesi i pretenduar është llogaritur (ligji, kontrata etj). Shkruaj ndaras shumën e interesit nëse kërkohet në kërkesën tuaj, në përputhje me nenin 31.3 të ligjit mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe aseteve të tyre.

21. Kush do të vlerësoj kërkesën time të kreditorit?

Administratori – Agjencia Kosovare e Privatizimit (PAK) vlerëson Kërkesën e Kreditorit në bazë të plotësimit të Formularit të Kërkesës për Riorganizim dhe dokumenteve mbështetëse. Kjo gjithashtu do të aplikohet për kërkesat që kanë të bëjnë me interesin e pronësisë në asete specifike ose kapital të ndërmarrjes. Sipas ligjit AKP-ja mund të delegoj këtë proces Ofruesit të Shërbimeve Profesionale të cilët duhet të vlerësojnë kërkesën tuaj në emër të AKP-së.

22. Kur mund të pres vendimin nga AKP-ja për kërkesën time të kreditorit?

AKP-ja vlerëson kërkesën tuaj pas pranimin të dëshmisë së kërkesës ose dëshmisë së interesit, dhe brenda nëntëdhjetë (90) ditëve ose kohës së tillë shtesë sa mund të lejohet nga Gjykata – do të ju njoftoj për çfarëdo kundërshtimi që Administratori ka.

Administratori gjithashtu do të ju njoftoj para mbledhjes konfirmuese për vlerën e pranuar të kërkesës suaj e cila ju jep të drejtë proporcionale të votimit brenda klasës me kreditorët tjerë, kërkesat/kërkesat e të cilëve janë pranuar.

23. Çka është Mbledhja Konfirmuese?

Mbledhja Konfirmuese thirret nga Administratori (AKP) në mënyrë që Kreditorët e Regjistruar të mund të votojnë për Planin Riorganizativ.

24. Çka është plani riorganizativ?

Plani Riorganizues është plan i parashtruar në Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës nga AKP-ja ose Kreditorët Kualifikues në procedurat e Ligjit për Riorganizim në të cilat përcaktohet shitja e aseteve. Plani duhet të miratohet nga Kreditorët e Regjistruar të NSH-së dhe Bartësit e Interesit të Regjistruar dhe nga Gjykata.

Plani për riorganizim përcakton obligimet e Ndërmarrjes (NSH) ndaj Kreditorëve të saj të Regjistruar/Bartësve të Interesit dhe mënyra e obligimeve të tilla për tu kryer. Me votimin e planit për riorganizim dhe konfirmimi i tij nga Gjykata, Gjykata lëshon një urdhër për implementimin e tij që është i detyrueshëm për përbushjen nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e riorganizimit.

25. Si votohet plani i riorganizimit?

Në mbledhjen konfirmuese Kreditorët e Regjistruar duhet të votojnë për ose anulimin e planit riorganizativ. Votimi duhet të bëhet në secilën klasë të kreditorëve ndaras nga kreditorët e asaj klase. Klasët e kreditorëve janë përcaktuar në ligj. Plani riorganizativ konsiderohet të votohet në klasë të kreditorëve nëse Kreditorët e Regjistruar e asaj klase që mbajnë vlerën e shumicës së borxheve të papaguara të NSH-së në atë klasë kanë votuar për planin.

Administratori duhet të regjistroj votat e kreditorëve në favor dhe kundër secilit plan të planeve në secilën klasë të kreditorëve. Bazuar në rezultatet nga votimi dhe çka është propozuar në planin riorganizativ dhe Gjykata duhet të konfirmoj ose anuloj planin riorganizativ.

Bartësit e interesit të regjistruar të cilët pretendojnë interesin në pronësi të kapitalit të Ndërmarrjes nuk votojnë në planin riorganizativ.

26. Ku mund të marrë kopjen e planit riorganizativ?

Administratori (AKP-ja) përgatit dhe dorëzon propozimin për planin e riorganizimit në komisionin e kreditorëve brenda 9 muajve pas datës së publikimit të Njoftimit për afatin e kreditorëve dhe kopja duhet të dorëzohet në gjykatë. Gjykata mund të zgjas periudhën e dorëzimit të planit deri në 15 muaj. Administratori (AKP) informon të gjithë kreditorët e regjistruar që nuk janë në komisionin e kreditorëve se plani është parashtruar në gjykatë dhe si mund ta marrin kopjen.

27. Çka është Komisioni i Kreditorëve?

Komisioni i Kreditorëve është komisioni i kreditorëve i emëruar nga Gjykata gjatë mbledhjes fillestare të kreditorëve. Komisioni i kreditorëve përbëhet nga një grup i personave që arsyeshëm konsiderohen si përfaqësues të të gjithë kreditorëve. Komisioni i kreditorëve përfshin dy (2) përfaqësues të punëtorëve dhe së paku tre (3) mirëpo jo më shumë se shtatë (7) të kreditorëve jo-punëtor të cilët kanë parashtruar dëshmitë e kërkesave tek Administratori në ose para afatit të kërkesave.

28. Çka është mbledhja fillestare e kreditorëve?

Mbledhja fillestare e kreditorëve është mbledhje e të gjithë kreditorëve të cilët kanë parashtruar dëshmi të kërkesës në ose para afatit të kërkesës. Kjo mbledhje mbahet jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas afatit të kërkesës, Gjykata mund të zgjas deri në tridhjetë (30) ditë shtesë. Administratori (AKP) informon së paku dhjetë (10) ditë paraprakisht për datën e mbledhjes fillestare të kreditorëve të gjithë kreditorët të cilët kanë parashtruar dëshminë e kërkesës për detajet e procesit të riorganizimit, të drejtat e kreditorëve dhe forma e komunikimit me administratorin dhe gjykatën. Në këtë mbledhje, gjykata emëron komisionin e kreditorëve që përfaqëson të gjithë kreditorët në procedurat e riorganizimit.

27. A do të pranosh shumën e përgjithshme që kam bërë kërkesën në formularin e dëshmisë së kërkesës sime?

Se sa para do të pranosh varet nga disa faktorë përfshirë masat e planit për riorganizim, vlerësimi i vlerës së likuidimit të të gjitha asetëve të ndërmarrjes dhe shumës së përgjithshme të kërkesave të pranuar të kreditorëve të tjerë. Pagesa e juaj gjithashtu do të ndikohet edhe nga renditja e kërkesës suaj, dmth a është “prioritet” i lartë ose i mbështetur me sigurim ose kërkesë e përgjithshme e pasiguar sipas ligjit. Plani riorganizativ sqaron cili është koncepti i propozuar i riorganizimit dhe se si duhen trajtuar klasët e ndryshme të

kreditorëve dmth, si, kur dhe në çfarë shume duhen paguar ose në çfarë mënyre mund të kompensohen. Pas njoftimit me propozimin për planin e riorganizimit secili kreditor ka të drejtë të votoj për ose kundër planit riorganizativ të propozuar.

28. Çfarë ndodh nëse plani riorganizativ nuk votohet/anulohet nga kreditorët e regjistruar?

Nëse plani nuk është konfirmuar nga gjykata pas votimit për planin, dmth plani ose votimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për konfirmimin e tij nga Gjykata, më pas gjykata mbyll procedurën e riorganizimit dhe e konverton në procedurë të rregullt të likuidimit, në procedurën e likuidimit AKP shet të gjitha asetet e ndërmarrjes dhe plotëson kërkesat e kreditorëve me të ardhurat nga shitja.